

JETA SHKENCORE

KONFERENCË PËRKUJTIMORE PËR VEPRËN E ALBANOLOGUT NORBERT JOKL

Më 6 maj 2022 u mbushën 80 vjet nga vdekja tragjike e albanologut të shquar Norbert Jokl si pasojë e mizorisë naziste. Me këtë rast Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Vjenës organizoi në datën 5 maj 2022 një konferencë përkujtimore për veprën e tij. Në konferencë ishin ftuar specialistë nga fusha e gjuhësisë historike dhe albanologjia, për të ndriçuar aspekte të ndryshme të veprës shkencore të Joklit dhe të ndikimit të saj në albanologjinë e mëvonshme. Konferenca u mbajt në një nga sallat e pallatit perandorak Hofburg, në qendrën historike të Vjenës.

Konferencën e hapën me përshëndetjet e tyre Rektori i Universitetit të Vjenës Heinz Engl, dekania e Institutit të Gjuhësisë Melanie Malzahn dhe profesori i gjuhësisë indoeuropiane Stefan Schumacher, të cilët u uruan mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe kujtuan me nderim figurën e ndritur të Norbert Joklit, përkushtimin e tij për studimet albanologjike dhe fundin e tij të dhimbshëm nga dhuna naziste.

Nën drejtimin e prof. Stefan Schumacherit, seanca e parë filloi me kumtesën e prof. Elton Priftit, akademik i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i cili foli për marrëdhëniet midis Norbert Joklit dhe Carlo Tagliavinit, përpjekjet e albanologut të shquar italian për shpëtimin e kolegut hebre nga persekutimi nazist, duke paraqitur një përshkrim historik-shkencor në bazë të arkivit privat të familjes Tagliavini. Më pas prof. Bardhyl Demiraj, akademik i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, kumtoi për lidhjet e ngushta, fillimisht mësues-nxënës e më pas miqësore, të Joklit me dishepullin e tij Eqrem Çabej, në bazë të letrave të Joklit drejtuar Çabejt e të ruajtura prej këtij në arkivin privat, sot të trashëguar nga Brikena Çabej.

Seanca e dytë u drejtua nga Joachim Matzinger, punonjës shkencor në Akademinë Austriake të Shkencave, i cili ia dha fjalën së pari Anila Omarit nga Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë i ASA-s, Tiranë, për të kumtuar mbi kontributin e Joklit për etnogjenezën shqiptare në një analizë kritike të veprës së studiuesit rus A. M. Seliščev. Më tej doktori i shkencave judaistike Thomas Soxberger, bashkë me studenten e Universitetit të Vjenës Iris Kamil, mbajti një lutje për të vdekurit (Hazkara) kushtuar Norbert Joklit.

Mbas pushimit të drekës seancën e drejtoi Anila Omari, e cila i dha fjalën së pari prof. Rexhep Ismajlit nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e

Kosovës për të mbajtur kumtesën “Mësimet e Norbert Joklit njëqind vjet më pas” ku u diskutuan tezat kryesore të Joklit dhe vijimi i tyre në ditët e sotme, e më pas Dr. Ina Arapit, studiuese e albanologjisë në Vjenë, për të folur mbi marrëdhëniet e Joklin me letërsinë shqipe, duke u përqendruar në studimet e tij shkencore mbi veprat e Naim Frashërit dhe shkrimtarëve të tjerë shqiptarë.

Seancën përmbyllëse e drejtoi Bardhyl Demiraj, në të cilën kumtuan Dr. Valeriana Karma, e doktoruar për gjuhësi historike në Universitetin e Vjenës, e cila paraqiti rezultatet e studimit të saj mbi mënyrën habitore (admirativin) në letërsinë folklorike shqipe, dhe Dr. Sergio Neri, Privatdocent për indoeuropianistikë në Universitetin e Mynihut, i cili duke ndjekur gjurmët e Joklit në studimet etimologjike të shqipes, paraqiti një analizë të thelluar etimologjike të emrit *burrë* në shqipe, me kontribute vetjake në debatin shkencor lidhur me këtë leksemë indoeuropiane të shqipes.

Kumtesat u ndoqën me interes dhe u shoqëruan me pyetje e diskutime nga auditori që përbëhej nga profesorë e studentë të universitetit të Vjenës, përfaqësues të bashkësisë hebraike të Vjenës etj.

Anila Omari